



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:291935

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05526429

P.nr.59/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i përgjithshëm- Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit B.Z nga Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Detyrimi nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2217/21, të datës 21.03.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 28.02.2024, në praninë e prokurores së shtetit Albana Parduzi, të dëmtuarit E.R, të pandehurit B.Z, si dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare Av. Rifat Bllata, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 26.03.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: B.Z, nga babai N. dhe nëna A., e vajzërisë H., i lindur me dt ..., Komuna e Vushtrrisë, ku edhe jeton, ka te kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes se dobët ekonomike, punon në fabrikën e prodhimit të dyerve dhe dritareve “A...”, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar për vepra penale me aktgjykimin P.nr. 1209/2019, si dhe P.nr. 93/2021.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE: Me datë 25.12.2021, rreth orës 21:00 në Vushtrri, pas marrëveshjes paraprake me qëllim që vetit t'i siguroj pasuri të kundërligjshme nga i dëmtuari – i mituri E.R ka marrë të hollat në vlerë prej 3,808 (tremijetëqindetë) euro, në atë mënyrë që ditën e lartcekur ka qenë edhe me dy persona të tjerë të panjohur në automjetin Golf 6 me ngjyrë hiri, me dritë të ndezur të rotacionit si automjet policor, dhe kur i dëmtuari ishte duke shkuar në qytet nga shtëpia e hallës së tij, të njëjtin e kanë ndalur në atë mënyrë që dy personat tjerë kanë dal nga automjeti duke i thënë që janë polic në rroba civile dhe duhet të vijë me ta në Stacion Policor, ku i dëmtuari ka hyrë në automjet dhe më pas drejtuesi i automjetit ka përdor dhunën ndaj tij duke e godit me duar në fytyrë, ndërsa i kanë kërkuar që t'ua sjell të hollat, duke e kanosur që do t'i bëjnë ndonjë të keqe atij dhe familjes së tij, në automjet në ulëset prapa ku kishte qenë ulur i dëmtuari bashkë me të kishte qenë edhe i pandehuri B.Z ku i dëmtuari e kishte njohur pasi që i njëjti ka një shenjë në vetullë, si dhe ka arritur ta njoh përmes mjekrës dhe mustaqeve, ku të dëmtuarin e frikësuar e kanë dërguar në lagje te F.S, ku i njëjti i kishte lënë të hollat, kishte hyrë në shtëpi dhe nga dollapi

i një dhome kishte marr të hollat, ia kishte dhënë të pandehurit i cili menjëherë me persona tjerë të panjohur kishte shkuar në drejtim të panjohur,

- Me këtë ka kryer veprën penale Detyrimi nga neni 328 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 7, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 46, 47, 48, 69, 70, 79 dhe nenit 328 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 449, 452, 462 të KPPK-së:

## E GJYKON

Të pandehurit B.Z gjykata i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej tremijë (3000) euro, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale tjetër në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve.

Të pandehurit koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.26.12.2021 deri më dt.25.05.2022 do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 100 (njëqind) euro, si dhe në emër të kompensimit të programit për viktimat e krimit të paguaj shumën prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga marrja e formës së prerë të këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar E.R për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullte juridiko civil.

## A r s y e t i m

### *Pjesa hyrëse e arsytimit të aktgjykimit*

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2217/21, të datës 21.03.2022, kundër të pandehurve B.Z nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Detyrimi nga neni 328 par. 1 të KPRK-së, si dhe të pandehurit E.B, nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Detyrimi nga neni 328 par. 1, në lidhje me nenin 33 par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt.25.03.2022 në të cilën të pandehurit e lartcekur janë deklaruar të pafajshëm, andaj gjykata i ka udhëzuar me të drejtat e tyre, kur më njëjtë kanë paraqitur kundërshtime të provave dhe kërkesa për hedhjen e aktakuzës, ndërsa që gjyqtari i vetëm gjykues përmes aktvendimit P.nr.72/2022 i dt.31.05.2022 ka refuzuar kërkesat e kundërshtimet e paraqitura nga ana e tyre, i cili është vërtetuar edhe me aktvendimin PN.nr.641/22 i dt.27.06.2022 i lëshuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 31.01.2023, në të cilën seancë i pandehuri B.Z është deklaruar i pafajshëm, ndërsa që i pandehuri E.B e ka pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, ashtu që gjykata me aktvendimin e dt.31.01.2023 ka veçuar procedurën ndaj të pandehurit B.Z, për shkak të veprës penale Detyrimi nga neni 328

par.1 të KPRK-së, ndërsa që ndaj të pandehurit E.B ka vazhduar me shpalljen e aktgjykimit dhe shqiptimin e dënimit.

*Prezantimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor*

Prokurorja e shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se i propozon gjykatës që gjatë shqyrtimit gjyqësor në cilësi të dëshmitares të dëgjohet i dëmtuari E.R, i cili do ta informoj gjykatën se si ka ardhur deri te rasti konkret, e po ashtu i ka propozuar gjykatës që në cilësinë e dëshmitarëve të dëgjohen N.M, A.B dhe B.A, të cilët do të dëshmojnë për rrethanat dhe veprimet e rastit konkret. Po ashtu i ka propozuar gjykatës që në procedurën e nxjerrjes së provave të merren parasysh raporti policor i hartuar nga ana e policisë i dt.28.12.2021, procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit E.R në polici, procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dyshuarve në polici dhe procesverbali mbi marrje në pyetje të dëshmitarëve të lartcekur, duke shtuar se bazuar në të gjitha këto do të vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë si në aktakuzë. Ndërsa në fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit ka deklaruar se pas administrimit te provave ne shqyrtim gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit te bazuar mire se i akuzuari e ka kryer veprën penale Detyrimi nga nenin 328 par.1 të KPRK-se, e qe kjo gjendje faktike është vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve, te dëmtuarit dhe te provave materiale, ashtu qe nga dëshmia e dëshmitares N.M është vërtetuar se e njëjta ia kishte dhënë paratë në shumën prej 4,000 franga të dëmtuarit E.R me qellim qe i njëjti t'ia konvertoj ne euro, qe ky konvertim i parave është bërë vërtetohet nga dëshmia e dëshmitarit B.A e dhëne ne stacion policor dhe para gjykatës dhe atë ne shumen prej 3,808 Euro. Ndërsa dëshmia kryesore me te cilën vërtetohet se i akuzuari është kryerës i veprës penale, është dëshmia e dëshmitarit njëherit te dëmtuarit E.R e dhëne ne këtë shqyrtim gjyqësor, i cili ne tërësi e ka sqaruar rastin duke e treguar edhe mënyrën se si e ka identifikuar te akuzuarin, e po ashtu këtë identifikim të të akuzuarit e ka bere edhe ne stacionin policor, kur te njëjtit i janë ofruar 11 fotografi te personave te ndryshme, ashtu qe ishte përgjigjur se personi me nr.7 ka qene i ulur mbrapa ne veturën Golf 6 dhe i cili ishte pjesëmarrës i kryerjes se kësaj veprës penale, e që ka rezultuar të jetë tani i pandehuri B.Z. Sa i përket mbrojtjes se te akuzuarit, i ka propozuar gjykatës që te njëjtën mos ta merr për bazë pasi qe e njëjta ishte kontradiktore me dy deklarime te ndryshme te dhëna ne stacionin policor, prandaj nga gjykata ka kërkuar qe te akuzuarin ta shpall fajtor, dhe ta dënoj sipas ligjit me qellim qe ky dënim ta arrinte efektin e qëllimit te dënimit, duke marr parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese, si rrethane renduese te merret parasysh fakti qe i njëjti ka qene edhe me parë i gjykuar.

I dëmtuari në fjalën hyrëse ka deklaruar se e mbështet fjalën e prokurorit të shtetit dhe njëherit ka kërkuar kompensim të dëmit lidhur me këtë çështje penale, i njëjti këtë deklarim e ka bërë në prezencën e prindit të tij. Në fjalën përfundimtare ka qëndruar prapa fjalës hyrëse.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën hyrëse ka deklaruar se e gjatë shqyrtimit të provave do të vërtetohet se i mbrojturi i tij nuk është kryes i veprës penale për të cilën akuzohet nga prokuroria e shtetit, ndërsa që i ka propozuar gjykatës që si prova personale të dëgjohen edhe E.Z, B.S, A.A, A.B1 dhe E.B. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjate shqyrtimit gjyqësor prokuroria me asnjë fakt, provë apo dëshmi, nuk ka mundur ta vërtetoj gjendjen faktike se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale në natën kritike. Pavarësisht deklaratave të dhënë në polici dhe ne gjykatë nga i dëmtuari E.R dhe i bashkëpandehuri E.B dhe A.B, si dhe B.A, nuk ka

mundur te vërtetohet gjendja faktike se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale e cila i vihet ne barre. Ne deklaraten e E.R te dhënë me dt.02.05.2023 ne këtë gjykate, ne faqen 6te, ne pyetjen e gjykatës se “a mund te na tregoni se cilët persona e kane pasur vetullën e prere”, dëshmitari është përgjigjur “shoferi e ka pasur vetullën e prere dhe flokët e shkurtra, e po ashtu me sa mbaj ne mend vetullën e prere e ka pasur edhe personi i ulur mbrapa” e qe ne këtë rast aludohet ne te pandehurin B.Z, me çka vet i dëmtuari edhe ne deklaratat e dhënë ne polici dhe ne gjykate nuk ka mundur te vërtetoj faktin se këtu ka qene vetëm një person me vetull te prere dhe flokë te shkurtra, e po ashtu ne faqen 4 te dhënë ne deklaraten ne polici te E.B me dt.21.02.2022 ne pyetjen e 3te dhe përgjigjen e 3te ka deklaruar se “jam tut ne stacion policor dhe për këtë arsye kam thënë se B.Z është i dyshuar”, qe do te thotë se pohimin e ka dhënë nga frika sipas vlerësimit te mbrojtjes. Ne rastin kur i dëmtuari E.R siç ka deklaruar ne polici dhe gjykate, paratë e këmbjera ne euro fillimisht me shokët e tij kane shkuar ne kafene, kane qëndruar një kohe te gjate me shokët e tij, i’u ka treguar për rastin e pastaj ka vendosur te shkoj t’i le ne shtëpi tek halla e tij, tek nena e B.1 ku ka qene shtëpia e hapur dhe i ka lënë ne një dollap, ku para dhe pas e kane ditur shume persona vendndodhjen e parave, përfshire A.B, B.S dhe A.B.1. Nga gjithë kjo rrjedh se deklaratat qe i kane dhënë i bashkëpandehuri, i dëmtuari dhe dëshmitarët janë dhënë nen presion, kurse në gjykatë janë deklaruar se nuk e njohin B.Z, te gjitha këto nënkuptojnë se ky rast ndaj te mbrojturit të tij është i montuar, ngase i njëjti nuk është kryerës i veprës penale, duke theksuar se edhe pse te njëjtit i është konfiskuar telefoni dhe ende mbahet i ruajtur nuk i është kthyer ende nuk ka asnjë ekzaminim nga i cili do të konstatoheshin bisedat telefonike dhe hartografia. Andaj i ka propozuar gjykatës qe ne mungese te provave materiale, gjykata te merr aktgjykim lirues ndaj te mbrojturit të tij, si dhe te njëjtit t’i kthehet telefoni i konfiskuar i mbajtur pa baze ligjore deri me tani.

I pandehuri në fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e avokatit mbrojtës.

#### *Provat që janë administruar në shqyrtim gjyqësor*

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të pandehurit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të pandehurit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, ashtu që gjatë shqyrtimit gjyqësor bëri administrimin e këtyre provave:

*Provat materiale:* Procesverbali për intervistimin e te pandehurit B.Z në S.Policor ne Vushtrri i dt.27.12.2021, procesverbali i marrjes ne pyetje te dëmtuarit E.R i dt.27.12.2021 ne Stacionin Policor ne Vushtrri, procesverbali i marrjes ne pyetje te dëshmitarit A.B i dt.20.12.2021 ne Stacionin Policor ne Vushtrri, Procesverbali për intervistimin e te pandehurit B.Z në DRP-Mitrovica Jug i dt.21.02.2022, procesverbali i marrjes ne pyetje te dëshmitarit B.A i dt.27.12.2021 ne Stacionin Policor ne Vushtrri, procesverbali i marrjes ne pyetje në procedurë paraprake të dëshmitares N.M i dt.26.12.2021, Raporti i oficerit i dt.26.12.2021, Raporti policor-policit hetues i dt.27.12.2021, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve te te pandehurit B.Z i dt.27.12.2021, i tel. i markës Iphone VI ngjyre hiri, vështrohet foto dokumentacioni dhe atë foto

nr.1 e cila përmban telefonin ne pjesën e përparme, foto nr.2 qe përmban telefonin ne pjesën e pasme, foto nr.3 dhe nr.4 po ashtu përmban telefonin ne pjesën e përparme dhe pjesën e pasme, vështrohet lista e 11 personave te dyshimtë lidhur me këtë rast dhe fotografitë e tyre por e cila nuk përmban arsyet e fotografimit, por janë të vendosur nr.6 dhe nr.7 si persona te dyshuar, si dhe *Provat personale*: Dëgjimin e të dëmtuarit E.R në cilësi të dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 02.05.2023, dëgjimin e dëshmitarit B.A në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.02.05.2023, dëgjimin e dëshmitarit A.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.02.2024, si dhe mbrojtjen e të pandehurit të paraqitur pranë kësaj gjykate në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.28.02.2024.

*Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet*

*Faktet jo kontestuese*

Për gjykatën është fakt jo kontestues se me datë 25.12.2021 i dëmtuari E.R është takuar me gruan e dajës së tij N.M në fshatin D, e cila ia ka dhënë të dëmtuarit shumën prej 4,000 franga me qëllim të konvertimit në euro dhe pastaj të njëjtat t’ia dorëzoj bashkëshortit të saj – dajës së të dëmtuarit.

Nuk është kontestuese se ditën kritike personat me emrin A.B, A.A, B.S dhe A.B.1, janë nisur për në fshatin D, ku e kanë marrë tani të dëmtuarin E.R dhe kanë vazhduar për në Vushtrri me qëllim të konvertimit të parave, dhe të njëjtat i kanë konvertuar frangat në euro në kundërvlerë prej 3,808 euro te lokali “D...”.

Nuk ishte kontestuese as se pas konvertimit të parave, i dëmtuari E.R së bashku me A.B dhe B.S kanë shkuar në kafenenë “M...” dhe aty bashkë me ta ka qëndruar edhe vëllai i A. – E.B.

Nuk ishte kontestuese se prej aty, i dëmtuari E., bashkë me B.S dhe A.B kanë vazhduar për në shtëpinë e hallës së të dëmtuarit, për t’i lënë paratë, të cilat paraprakisht i kishin konvertuar në euro, dhe se i dëmtuari bashkë me djalin e hallës së tij B.S kanë hyrë brenda në shtëpi dhe i kanë lënë mjetet, ndërsa që jashtë në oborr ka qenë duke i pritur shoku i tyre A.B.

Për gjykatën është fakt jo kontestues se më dt. 25.12.2021, rreth orës 21:00 në Vushtrri kur i dëmtuari ishte duke dal në qytet bashkë me B.S dhe A.B, të njëjtat i kanë ndalur dy persona të cilët kanë qenë me automjetin “Golf 6”, duke i pyetur se cili nga ta është E.R, duke ju thënë që janë polic në rroba civile dhe se i njëjti duhet të shkoj me ta në Stacion Policor, dhe i dëmtuari ka hyrë në automjet, ndërsa dy personat me të cilët ka qenë kanë vazhduar për në qytet.

Të gjitha këto fakte të pohuara edhe nga vetë palët.

*Faktet kontestuese*

Fakt kontestues për gjykatën dhe i domosdoshëm për tu provuar ishte fakti se a është i pandehuri kryes i veprës penale të lartcekur, ashtu siç përshkruhet në dispozitiv të aktakuzës, përkatësisht a e ka detyruar me përdorim të forcës dhe kanosjes i pandehuri të dëmtuarit që i njëjti të veproj në dëm të pasurisë së tij, duke e detyruar t’ua dorëzoj shumën e parave prej 3,808 euro, së bashku dhe me dy persona tjerë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror?

Po ashtu fakt kontesues për gjykatës është se a ka qenë i pandehuri personi i cili ka qëndruar prapa ulur në veturën Golf VI me të dëmtuarin, i cili fillimisht është shtirur se edhe ky është arrestuar nga policia si kryes i ndonjë veprë penale?

*Si i ka vërtetuar gjykata faktet kontestuese*

Meqenëse i pandehuri me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë, nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, gjykata për vërtetimin e faktit kontestues të lartë cekur, si element qenësor për përmbushjen e figurës së veprës penale me të cilën ngarkohet i pandehuri, ka zhvilluar procedurën e provave, ku ka administruar këto prova:

*Provat personale*

I dëmtuari E.R i dëgjuar në cilësi dëshmitarit, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datë 02.05.2023 ka deklaruar se e mbështet deklaratën e dhënë në polici lidhur me rastin në fjalë, ndërsa që lidhur me ditën kritike ka deklaruar se ka qenë ora rreth 15:00 deri 15:30, ku në fshatin e tij në D rastësisht e ka parë gruan e dajës N.M e cila jeton në Gjermani, e cila ka qenë me foshnjën e vet në automjet, e njëjta e ka pasur nënën e sëmure dhe i ka tregu se i ka 4,000 Franga dhe ka dashur që t'i këmbëj në Euro, e njëjta e ka pyetur se ku mundem me i këmbë, i njëjti i ka treguar se e ka kushëri B.A i cili bën këmbim dhe i ka marr paratë, ka shkuar në shtëpi, e ka bërë një dush, pastaj autobusi i cili qarkullon nga fshati D ka ikur, dhe e ka thirr A.A, të cilin e ka pasur fqinjë dhe nga i njëjti ka kërkuar që të vijë dhe ta marr, dhe i njëjti ka ardhur dhe e ka marr me makinën "Seat" dhe në veturë kanë qenë edhe personat me emrat A.B, A.B.1 dhe B.S, dhe janë nisur në drejtim të Vushtrrisë për t'i këmbyer paratë, ku A.1 është ndarë nga ta pasi që ka thënë se ka punë, ndërsa këta të katërt i kanë këmbyer 4,000 Franga në kundërvlerë prej 3,808 Euro, më pas kanë shkuar për të pirë kafe në kafenenë "M...", më pas A.A është ndarë nga ta dhe ka vazhduar për në shtëpi, ndërsa që i njëjti bashkë me A.B dhe B.S janë nisur për të shkuar te halla e të dëmtuarit, në Vushtri, më pas në këtë lagje e kanë takuar E.B, i cili i ka pyetur se ku po shkoni dhe A.B i ka thënë se po i dërgojmë paratë te B.S. Ka shtuar se disa herë E.1 e ka thirrur ne telefon A., të cilin e ka edhe vëlla, pastaj së bashku me B.S dhe A.B i kanë lënë të hollat te shtëpia e B.S, të cilin njëherit e ka djalë të hallës, ku me të njëjtin kanë hyrë brenda në shtëpi, ndërsa A. i ka pritur jashtë në oborr dhe më pas kanë dashur të shkojnë për të luajtur Sonny. Ka shtuar se nuk ka shkuar që t'i dorëzoj mjetet menjëherë te gruaja e dajës së tij sepse e njëjta ka qenë të nëna e vet e cila ishte e sëmure, ndërsa ka theksuar se E.1 në vazhdimësi ka insistuar për t'a ditur se ku po shkojnë dhe i njëjti i ka pyetur vazhdimisht, dhe pasi që i kanë lënë paratë te shtëpia e hallës së tij të njëjtit i kanë treguar se po shkojnë për të luajtur Sony në qendër. Kur kanë dal nga lagja, e kanë vërejtur një Golf 6, ngjyrë hiri me rotacion, i cili i ka ndalur, ku në veturë kanë qenë dy persona të cilët janë paraqitur si polic, të njëjtit i kanë pyetur se a je E.R dhe i kanë thënë eja me ne stacion policor, më pas i njëjti duke menduar se janë polic, ka hipur në veturë dhe ka qenë edhe një person i tretë në veturë, gjoja se edhe ky ka qenë person që ka bërë ndonjë veprë penale, ku në bazë të mjekrës dhe vetullës së prerë, mendon se që ka qenë B.Z, ndërsa personat tjerë nuk i ka njohur sepse nuk i ka parë sepse ka qenë mbrëmje rreth orës 21:30. Ka theksuar se personat e ulur përpara në automjet nuk i ka njohur, ndërsa që B.Z ka qenë i ulur mbrapa dhe të njëjtin e ka identifikuar përmes mjekrës. Lidhur me të pandehurin B.Z ka theksuar se i njëjti është paraqitur se kinse është rrahur nga policia, ku pastaj kanë vazhduar në drejtim të

fshatit N, dhe e kanë ndalur veturën te Auto Pjesë “R...” dhe kanë filluar ta kërcënojnë se ku i ke lënë paratë dhe më pas kanë filluar ta kërcënojnë me familje të djalit të hallës së tij B.S se do t’i gjejë ndonjë e keqe nëse nuk do t’ua jap paratë, dhe më pas me veturë kanë shkuar në lagjen e djalit të hallës, i njëjti ka hyrë në shtëpi dhe i ka marr mjetet dhe të njëjtat i’a ka dhënë personit që ka qenë duke vozitur, i cili ka shkuar deri në gjysmë të oborrit me të, ku në shtëpi nuk ka qenë askush kur i ka marr mjetet, dhe i kanë thënë mos fol me askënd. Me këta tre persona nuk është takuar asnjëherë më parë. Më pas është nisur për të dal nga lagja, e ka takuar motrën e A., E.B1 dhe i ka thënë a ma jap telefonin të bisedoj me A., dhe pastaj e ka takuar A. te kafe-çajtorja R..., dhe më pas i ka treguar se çka ka ndodhur. Ka shtuar se të nesërmen e ka informuar gruan e dajës se çka i ka ndodhur, po ashtu e ka informuar edhe prindin e tij. Ndërsa në pyetjen e gjykatës se “A mund të na tregoni cili nga personat e ka pasur vetullën e prerë” i njëjti është përgjigjur se shoferi e ka pasur vetullën e prerë dhe flokë të shkurtra, po ashtu me sa e mban në mend vetullën e prerë e ka pasur edhe personi që ka qenë ulur prapa me të.

Dëshmitari B.A në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.02.05.2023, ka deklaruar se E.R e njuh pas rastit që ka ndodhë lidhur me këtë aktakuzë, duke shtuar se zakonisht deri në ora 18:00 punon në lokal dhe pasi ka shkuar në shtëpi e ka thirre një numër i telefonit ... dhe e ka njoftuar se gjendet para lokalit të tij dhe kanë me i këmbye disa franga, ku i njëjti e ka pyetur se kush jeni, i njëjti i ka treguar se është bashkë me A.A, të cilin dëshmitari e ka kushëri. Ka shkuar te lokali, ka hyrë në lokal dhe se aty kanë qenë E.R me A.A, dhe dy të tjerë që nuk i mban në mend, ua ka dhënë eurot dhe i ka marr frangat, ku me sa i kujtohet kanë qenë 4,000 franga dhe disa monedha të hekurit, pastaj i njëjti ka vazhduar për në shtëpi, ku të nesërmen e ka hapur dyqanin në ora 07:25 dhe më pas ka shkuar një police, dhe e ka pyetur se a ke këmbyer valuta në këtë kohë dhe unë i ka treguar se po kam këmbyer pas orës 19:00, dhe më pas kanë shkuar policia dhe kanë kërkuar që të jap deklaratë.

Dëshmitari A.B në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.15.02.2024, ka deklaruar se me datë 25.12.2021, së bashku me A.A, B.S dhe A.B.1, janë nisur për në fshatin D, ku e kanë marrë E.R dhe kanë vazhduar për në Vushtrri me qëllim të kthimit të frangave në euro, të cilat kanë qenë të dajës së E, dhe të njëjtat i kanë konvertuar të “D...”, në mbrëmje, koha e saktë nuk i kujtohet. Tutje ka shtuar se prej aty kanë shkuar në kafenenë “M...”, e cila gjendet në Vushtrri, së bashku me E.R, B.S dhe vëllain e tij E.B dhe kanë qëndruar rreth 40min, ku prej aty janë nisur për shtëpi me E. dhe B.1 dhe rrugës e ka takuar vëllain e tij, ku i njëjti i ka pyetur se ku po shkoni, të njëjtit i kanë thënë se po shkojmë në shtëpi, ashtu që duke shkuar në shtëpi përsëri e ka takuar të njëjtin tek dera e shtëpisë dhe përsëri i ka pyetur se ku po shkoni, i kanë thënë se po shkon E. me i fsheh paratë tek shtëpia e B.S. Pasi kanë arritur te shtëpia e hallës së E.R, ai së bashku dhe B.S – djalin e hallës së tij kanë hyrë brenda dhe i kanë fshehur paratë në shtëpinë e këtij të fundit, pastaj e ka thirre vëllai që të dal në mëhallë, i cili ka qenë në këmbë dhe ka qenë vetëm, dhe e ka pyetur a i ke paratë ti, dhe i njëjti i ka thënë se jo nuk i kam, pastaj ai ka ecur dhe i njëjti ka shkuar prapë tek shtëpia e B.S, prej aty kanë dalë dhe e kanë parë një Golf 6, ngjyrë hiri, ku drejtuesi i automjetit posa i ka parë ka ecur me shpejtësi dhe prapë të njëjtin e kanë parë duke lëvizur prapa tyre me shpejtësi të vogël, pastaj drejtuesi i automjetit e ka kthyer veturën tek trafo dhe e ka ndalur veturën para këmbëve të tyre, dhe kanë pyetur se cili është E., por të njëjtit e kanë ditur sepse kanë shkuar në drejtim të E., të njëjtit kanë pasur kapela të duksave, duke theksuar se nuk

ua ka parë fytyrat e tyre. Tutje ka shtuar se të njëjtit nuk janë prezantuar, fillimisht kanë pyetur cili është E. dhe pastaj kanë shkuar në drejtim të tij, dhe të njëjtit i kanë thënë E. që të hyjë në veturë, dhe më pas E. ka hipur në veturë, dhe pastaj të njëjtit kanë vazhduar në kafenenë e quajtur “R...”, dhe pastaj motra e ka thirrë në telefon, përmes atij telefoni E. ka komunikuar me të dhe e ka pyetur ku jeni, i njëjti i ka treguar se në cilën kafe janë, dhe pasi ka shkuar E. në kafe ju ka treguar se ata persona ia kanë marrë mjetet, i cili ju ka thënë se në veturë kur ka qenë, të njëjtit ia kanë vendosur armën në drejtim të fytyrës dhe i kanë thënë se nëse nuk i qet paratë, kemi me të dërguar në polici, pasi që të njëjtit ja kanë prezantuar një ID, duke ju treguar se si ka hyrë në shtëpi, ku njëri nga personat e ka përcjellë deri në oborrin e shtëpisë, pastaj E. ka hyrë brenda në shtëpi ku i ka fshehur paratë dhe ua ka dorëzuar.

### *Provat materiale*

Nga Procesverbali për intervistimin e të pandehurit B.Z në S.Policor ne Vushtrri i dt.27.12.2021, vërtetohet se i njëjti ka deklaruar se më dt.25.12.2021 rreth orës 21:25 ka qenë duke shkuar në shtëpi ose brenda në shtëpi, ndërsa ka shtuar se personin me emrin E.R nuk e njeh as nuk ka pasur njohuri se ndonjë person në ditën e lartcekur ka pasur ndonjë shumë të madhe të hollave në kafenenë “M...”, duke shtuar se në këtë kafe ka qenë ditën kritike bashkë me shokun e tij E.Z. E ka mohuar t’ia ketë marr E.R shumën e parave po ashtu ka theksuar se nuk e din se kush ka mundur t’ia marr. Ka shtuar se E.B e njeh shok pas shoku ndërsa që shokët e tij nuk i njeh, ndërsa që ka theksuar se nuk rrinë bashkë me të. Ka theksuar se E.1 e ka përshëndet në ditën kritike ku ai ishte duke dal jashtë lokalit dhe ky ishte duke hyrë ndërsa që nuk ka biseduar me të.

Nga procesverbali i marrjes ne pyetje te dëmtuarit E.R i dt.27.12.2021 ne Stacionin Policor ne Vushtrri, ka deklaruar se më dt.25.12.2021 rreth orës 15-15:30 min e ka parë rastësisht gruan e dajës së tij në fshatin e tij D, te shkolla, e cila ishte me beben e saj me veturë, e cila është ndalur ta përshëndes të njëjtin dhe të njëjtën kohë e ka thirr motra e saj e cila i ka thënë të shkoj sepse nënën e kanë të sëmurë, ku e njëjta ia ka dhënë të dëmtuarit 4,000 franga e cila i ka thënë se këto para duhet t’ia japësh bashkëshortit të saj – daja i të dëmtarit, duke i thënë se nëse mundesh konvertoj në euro, i njëjti ka shkuar në shtëpi, e ka bërë një dush, pastaj autobusi i cili qarkullon nga fshati D ka ikur, dhe e ka thirr A.A, të cilin e ka pasur fqinjë dhe nga i njëjti ka kërkuar që të vijë dhe ta marr, dhe i njëjti ka ardhur dhe e ka marr me makinën “Seat” dhe në veturë kanë qenë edhe A.B, A.B.1 dhe B.S, dhe janë nisur për t’i këmbyer paratë, ku A.B.1 është ndarë nga ta duke ju thënë se kishte punë, ndërsa këta të katërt kanë vazhduar dhe i kanë këmbyer paratë te “D...” dhe pasi i kanë këmbyer 4,000 Franga dhe i ka ra 3,808 Euro, më pas kanë shkuar për të pirë kafe me A.B, A.A dhe B.S, kanë qëndruar rreth një orë dhe më pas janë nisur për të shkuar nëpër shtëpia, ku A.2 u nda nga ta te varrezat dhe më pas i njëjti është nisur për të shkuar te halla në Vushtrri, më pas në këtë lagje e kanë takuar E.B, i cili i ka pyetur se ku po shkoni dhe A.B i ka thënë se po i dërgojmë paratë te B.S, pastaj së bashku me B.S dhe A.B i kanë lënë të hollat te shtëpia e B.S, të cilin njëherit e ka djalë të hallës, ku me të njëjtin kanë hyrë brenda në shtëpi, ndërsa A. i ka pritur jashtë në oborr dhe më pas janë nisur me qëllim për të shkuar për të luajtur Sonny, ku prapë e kanë takuar E.B dhe i ka pyetur se ku po shkoni dhe të njëjtit i kanë thënë se po shkojmë të luajmë Sonny, dhe kur janë dal nga mëhalla, janë kthyer rrugës kah varrezat në rrugë ju ka dal një Golf 6, ngjyrë hiri, me rrotacion si të policisë, ku personat të cilët kanë qenë në atë automjet janë prezantuar si polic, të njëjtit i kanë pyetur se a je E.R dhe i kanë



thënë eja me ne stacion policor, më pas duke menduar se janë polic, ka hipur në veturë dhe ka qenë edhe një person i tretë në veturë, gjoja se edhe ky ka qenë person që ka bërë ndonjë vepër penale, ku drejtuesi i automjetit dhe pasagjeri janë bërë kinse po e rrahin të njëjtin, ndërsa ndaj të dëmtuarit kanë filluar të përdorin dhunë, ku shoferi e ka goditur me dorë në fytyrë, duke i thënë se duhet t'ia jap paratë. Tutje ka theksuar se personi i cili ka qenë ulur prapa me të ka pasur mustaqe, dhe trup mesatar. Të njëjtit me veturë e kanë dërguar te shtëpia e hallës së tij dhe i kanë thënë të shkoj t'i merr paratë ku pasagjeri e ka pritur jashtë veturës dhe i njëjti ka hyrë në shtëpi, i ka marr paratë dhe ua ka dorëzuar ku të njëjtit i kanë thënë se je i lirë dhe mos i trego askujt për këtë ngjarje. Më pas është nis për të dal nga lagja, ku e ka takuar motrën e A., E.B.1 dhe i ka thënë a ma jap telefonin të bisedoj me A., dhe pastaj e ka takuar A. te kafe-çajtorja R..., dhe më pas i ka treguar se çka ka ndodhur. I njëjti i ka përshkuar personat të cilët e kanë detyruar t'ua jap paratë, ku drejtuesi i automjetit ka pas flok të zeza të shkurta, njërin vetull të premë, pak më i shkurt me trup, i moshës rreth 22 vjeç, pasagjeri ka pasur të vendosur në kokë kapele – kaqket të zezë, me trup i gjatë dhe i gjerë në krah, ka pasur të veshur jakne të zezë, i moshës mbi 35-36 vjeç, ndërsa personi i cili ka qenë ulur mbrapa me të ka pasur mustaqe të zeza, kapele të duksit të vendosur në kokë. Nga ky procesverbal vërtetohet se zyrtari policor i cili e ka intervistuar të dëmtuarin ia ka prezantuar 11 fotografi, duke e pyetur se a është ndonjëri nga këta persona prej atyre që të kanë marrë me veturë dhe i njëjti ka arritur të identifikoj personin në foton me numër 7, duke theksuar se i njëjti ka qenë i ulur në veturën Golf 6 me të prapa, duke shtuar se të njëjtit i ka rënë telefoni në veturë prapa dhe ja ka parë foton e tij në telefon, duke shtuar se “telefoni është i njëjti me këtë që po e shoh në tavolinë.”

Nga procesverbali i marrjes ne pyetje te dëshmitarit A.B i dt.20.12.2021 ne Stacionin Policor ne Vushtrri, ka deklaruar se më dt.25.12.2021 së bashku me A.A, B.S dhe A.B.1 janë nisur në drejtim të fshatit D për ta marrë E.R dhe për ta dërguar në Vushtrri me qëllim të konvertimit të parave franga në euro. Pasi që e kanë marrë të njëjtin kanë shkuar në lokalin “M...”, kanë qëndruar rreth një orë dhe duke shkuar në shtëpi vëllai i tij E.1 e ka pyetur se ku po shkoni dhe i njëjti i ka treguar se po shkojnë në shtëpi, ku te dera e shtëpisë përsëri e ka takuar të njëjtin dhe e ka pyetur se ku po shkoni dhe i njëjti i është përgjigjur se po shkojnë për t'i fshehur paratë tek shtëpia e B.S, e cila gjendet pak metra larg shtëpisë së tyre, duke theksuar se kanë shkuar në shtëpi dhe i kanë lënë paratë, ku vëllai i tij e ka thirr dhe i ka thënë që të del në fund të lagjes, dhe kur janë takuar i njëjti e ka pyetur se ku i kanë lënë paratë dhe i njëjti i ka treguar se i kanë lënë në shtëpi te B.S, dhe pastaj i njëjti është larguar dhe kur dëshmitari bashkë me të dëmtuarin dhe B.S kanë dal në rrugë e kanë takuar automjetin e tipit Golf VI, ngjyrë hiri dhe me të vërejtur të njëjtit ai është larguar nga mëhalla, më pas kur kanë dal nga mëhalla dhe janë nis në drejtim të qytetit, automjeti në fjalë ju është vu nga pas dhe i njëjti është ndal të këmbët e tyre, ku dy persona kanë dal nga vetura dhe kanë shkuar në drejtim të E. dhe e kanë pyetur se a je ti E., ku pastaj të njëjtit i kanë thënë të hyjë në veturë dhe e kanë marr me vete, ku pastaj E. e ka thirr nga telefoni i motrës së dëshmitarit, janë takuar me të dhe i njëjti ju ka treguar se çfarë i ka ndodhur.

Nga Procesverbali për intervistimin e te pandehurit B.Z në DRP-Mitrovice Jug i dt.21.02.2022, ka deklaruar se më dt.25.12.2021 rreth orës 21:25 ka qenë në kafenenë “M...” së bashku me shokun e tij E.Z duke shtuar se beson se aty ka qëndruar deri në ora 21:35min. Ka theksuar se ditën kritike nuk është takuar me E.B pasi që tërë ditën ka qenë në punë. Ka theksuar se nuk e

njeh E.R e as shokët e tij. Ka mohuar se është i përfshirë në ndonjë mënyrë në kryerjen e veprës penale.

Nga procesverbali i marrjes ne pyetje te dëshmitarit B.A i dt.27.12.2021 ne Stacionin Policor ne Vushtrri, ka deklaruar se më dt.25.12.2021 rreth orës 18:00 i njëjti e ka mbyll dyqanin e tij mobile shop “D....” që gjendet në Vushtrri, dhe ka shkuar në shtëpi, ndërsa rreth orës 19:00 përmes numrit të telefonit ... e ka thirr një person dhe i ka thënë se jam para dyqanit tënd dhe i njëjti ka shkuar dhe është takuar me 3-4 persona, dhe një djalë që ishte në mesin e tyre i moshës së re ia ka dhënë 4,000 franga ku për kundërvlerë i njëjti ia ka dhënë 3,800 euro, ku pastaj i njëjti ka vazhduar në shtëpi, ndërsa personat e lartpërmendur janë shpërndarë nga lokali. Ka shtuar se prej personave që i ka njohur ka qenë vetëm A.A, djali i K.A.

Nga procesverbali i marrjes ne pyetje në procedurë paraprake të dëshmitares N.M i dt.26.12.2021, ka deklaruar se më dt.25.12.2021 rreth orës 15:00 ka qenë duke shkuar në fshatin D, Vushtrri, te kunata e saj, ku e ka takuar djalin kunatës E.R i moshës 15 vjeç, ku të njëjtit ia ka dhënë 4,000 franga të Zvicrës, duke i thënë që t’ia jap bashkëshortit të saj A.3, ku i njëjti i ka marr të hollat dhe ka vazhduar në drejtim të fshatit D – Vushtrri, ndërsa e njëjta ka vazhduar për në fshatin P. pasi që e ka pasur nënën e sëmure, ndërsa të nesërmen E. e ka thirr bashkëshortin e saj në telefon duke i thënë se a mund të takohemi në Mitrovicë dhe pasi janë takuar i njëjti i ka thënë se paratë nuk i ka pasi që e kanë ndal tre person ame armë dhe i kanë thënë se i ke 3,800 euro te shtëpia e djalit të hallës dhe e kanë detyruar të shkoj aty duke e pritur jashtë dhe i njëjti ka hyrë në shtëpi, i ka marr paratë dhe ua ka dorëzuar atyre, ku të njëjtit i kanë thënë se nëse tregon për këtë ngjarje do të vrasim. Tutje ka shtuar se E. ka deklaruar se ka qenë të varrezat e qytetit me një shok dhe me djalin e hallës kur tre persona të cilët kanë qenë me golf VI e kanë ndalur, ndërsa ka shtuar se për paratë të cilat i ka dërguar në shtëpi të hallës së tij e kanë ditur djali i hallës dhe shoku i tij.

Nga Raporti i oficerit i dt.26.12.2021, vërtetohet se me dt.26.12.2021 rreth orës 19:10 në S.P. Vushtrri ka shkuar ankuesja N.M, me qëndrim të përkohshëm në Gjermani, e cila ka raportuar se më dt.25.12.2021 deri sa ishte në vizitë te kunata e saj në fsh.D – Vushtrri, personit me emrin E.R ia kishte dhënë shumën prej 4,000 franga zvicerane për t’ia këmbyer në euro, mirëpo i njëjti i kishte thënë se pasi që i ka këmbyer paratë diku rreth orës 21:30 në rrugën “L.S”, ishte ndalur nga dy persona të cilët kishin dal nga vetura golf 6 kurse një person i dyshimtë kishte qëndruar në veturë, ku të njëjtin e kishin futur me detyrim në veturë dhe në të njëjtën kohë e kishin detyruar të shkoj te shtëpia e hallës së tij që të marrë shumën prej 3,800 euro duke ua dhënë personave të dyshuar dhe më pas të njëjtit janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Nga Raporti policor- policit hetues i dt.27.12.2021, vërtetohet se me dt.26.12.2021 rreth orës 19:40 në S.P. Vushtrri ka shkuar ankuesja N.M, me qëndrim të përkohshëm në Gjermani, e cila ka raportuar se më dt.25.12.2021 deri sa ishte në vizitë te kunata e saj në fsh.D – Vushtrri, e ka takuar djalin e kunatës E.R i moshës 15 vjeçare, të cilit ia kishte dhënë shumën prej 4,000 franga zvicerane për t’ia këmbyer në euro, duke i thënë që t’ia jap A.3 – burrit të saj, ndërsa që më dt.26.12.2021 rreth orës 18:30 min, bashkëshortin e saj e ka thirr ne telefon E. dhe i ka thënë që të takohen në Mitrovicë, ku i ka treguar se mbrëmë se ishte ndalur nga tre persona me armë duke i thënë se qiti paratë ndash mos me të vra, dhe në të njëjtën kohë e kishin detyruar të shkoj te

shtëpia e hallës së tij që të marrë shumën prej 3,800 euro duke ua dhënë personave të dyshuar dhe më pas të njëjtit janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të pandehurit B.Z i dt.27.12.2021, vërtetohet se nga i njëjti është konfiskuar telefoni i markës Iphone VI ngjyre hiri.

Nga vështrimi i foto dokumentacionit dhe atë foto nr.1 e cila përmban telefonin në pjesën e përparme, foto nr.2 që përmban telefonin në pjesën e pasme, foto nr.3 dhe nr.4 po ashtu përmban telefonin në pjesën e përparme dhe pjesën e pasme.

Nga vështrimi i listës së 11 personave të dyshimta lidhur me këtë rast dhe fotografitë e tyre por e cila nuk përmban arsyet e fotografimit, por janë të vendosur nr.6 dhe nr.7 si persona të dyshuar.

I pandehuri në mbrojtjen e paraqitur pranë kësaj gjykate ka deklaruar se më dt.25.12.2021, ka qene në punë paradite, në firmën “ AB....”, në ora 16:00 e ka përfunduar punën dhe ka shkuar në shtëpi, me pas ka dal në qytet në ora 18:00 dhe është takuar me shokun e tij E.Z. Me pas kanë shkuar në kafiterinë “M...” ku kanë qëndruar rreth 30 minuta, dhe me pas ka shkuar në shtëpi rreth orës 20:10 minuta, me taxi dhe me pas nuk ka dal nga shtëpia. Në pyetjen e prokurorit se “ne deklaratën e dhënë në polici me dt.27.12.2021, në pyetjen e policisë se a keni folur atë natë në kafiteri “M...” me personin E.B, jeni përgjigjur se e keni përshëndetur duke kaluar”, i njëjti ka deklaruar “po e kam përshëndetur nga distanca.” Në pyetjen e prokurorisë se “Me ke keni shkuar në shtëpi?”, i pandehuri është përgjigjur se “Vet kam shkuar, ndërsa shokun e kam lënë në qytet”. Në pyetjen e gjykatës se, “Ju në polici në pyetjen e parashtruar se ku keni qene me dt.25.12.2021, rreth orës 21:25 min, ju keni thënë se kam qene duke shkuar në shtëpi ose brenda në shtëpi, ndërsa sot keni thënë se në shtëpi kam shkuar në ora 20:10, cila është e vërteta”, i pandehuri është përgjigjur se “e vërteta është ashtu siç kam deklaruar edhe me herët, asaj deklarate i përmbahem”. Në pyetjen e gjykatës se, “sa veta keni qene në taxi?”, i njëjti është përgjigjur se “kemi qene 3 persona, por nuk i mbaj në mend se kush kanë qene ata.” Në pyetjen e gjykatës se, “ju me herët deklaruat se nuk e njihni E.B, ndërsa në pyetjen e parashtruar nga policia, ju keni thënë se “ E.1 e njoh shok mas shokut, ndërsa shokët e tij nuk i njoh”, i pandehuri ka deklaruar se “mbetem në tërësi pranë deklaratës që e kam dhënë në polici, nëse kam thënë ashtu e përkrah atë deklaratë.”

#### *Gjendja faktike e vërtetuar nga ana e gjykatës*

Gjykata, pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, analizimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, si dhe shikimit në shkresat e lëndës vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari me datë, kohë dhe vend si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ka ndërmarrë veprimet inkriminuese për veprën penale me të cilën ngarkohet.

#### *Vlerësimi sipas ligjit i provave nga ana e gjykatës*

Gjykata shqyrtoj me vëmendje të gjitha provat e administruara në shqyrtim gjyqësor dhe atyre që gjenden në shkresat e lëndës dhe provave të cilat shfaqin lidhshmërinë e plotë të të pandehurit me veprën penale të kryer u fali besim të plotë, pasi që të njëjtat janë marrë në procedurë të rregullt ligjore, e sidomos gjykata u fali besim deklarimeve të të dëmtuarit, pasi që deklarata e tij e dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor, është në përputhje me deklaratën e dhënë në polici,

në të cilën në përpikëri e kishte sqaruar rrjedhën kronologjike të rastit, dhe deklaratimet e të njëjtit gjejnë mbështetje edhe me provat e tjera të lëndës dhe atë procesverbalin e marrjes në pyetje të dëshmitarit A.B i dt.20.12.2021 në Stacionin Policor në Vushtrri si dhe deklarata e tij e dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.15.02.2024, procesverbalin e marrjes në pyetje të dëshmitarit B.A i dt.27.12.2021 në Stacionin Policor në Vushtrri si dhe deklarata e tij e dhënë në shqyrtim gjyqësor të dt.02.05.2023, procesverbalin e marrjes në pyetje në procedurë paraprake të dëshmitares N.M i dt.26.12.2021, nga të cilat deklarata vërtetohet se më dt.25.12.2021 rreth orës 15-15:30 i dëmtuari E.R deri sa ishte duke qëndruar të shkolla në fshatin e tij D e ka parë rastësisht gruan e dajës së tij, e cila e cila ka qenë me beben e saj me veturë, është ndalur ta përshëndes të njëjtin dhe të njëjtën kohë e ka thirr motra e saj e cila i ka thënë të shkoj sepse nënën e kanë të sëmurë, ku e njëjta ia ka dhënë të dëmtuarit 4,000 franga e cila i ka thënë se këto para duhet t'ia japësh bashkëshortit tim – dajës së të dëmtuarit, duke i thënë se nëse mundesh konvertoj në euro, i njëjti ka shkuar në shtëpi, e ka bërë një dush, pastaj e ka thirr A.A, të cilin e ka pasur fqinjë dhe nga i njëjti ka kërkuar që të vijë dhe ta marr, dhe i njëjti ka ardhur dhe e ka marr me makinën “Seat” dhe në veturë kanë qenë edhe A.B, A.B.1 dhe B.S, dhe janë nisur për t'ia këmbyer paratë, ku A.B1 është ndarë nga ta duke ju thënë se kishte punë, ndërsa këta të katërt kanë vazhduar dhe i kanë këmbyer paratë të “D...” dhe pasi i kanë këmbyer 4,000 Franga në kundërvlerë prej 3,808 Euro, më pas kanë shkuar për të pirë kafe me A.B, A.A dhe B.S në kafenenë “M...” në Vushtrri, ku kanë qëndruar rreth një orë dhe me ta ka qëndruar edhe E.B – vëllai i A.B, dhe lidhur me paratë të njëjtit kanë biseduar në prezencë të tij, nga edhe ky i fundit e ka kuptuar se tani i dëmtuari ka shumë parave të lartcekur, dhe më pas janë nisur për të shkuar nëpër shtëpia, ku A.2 është nda nga ta te varrezat, ndërsa këta të tre kanë vazhduar rrugën për të shkuar te halla e të dëmtuarit në Vushtrri, më pas në këtë lagje e kanë takuar E.B, i cili i ka pyetur se ku po shkoni dhe A.B i ka thënë se po i dërgojmë paratë të B.S, pastaj së bashku me B.S dhe A.B i kanë lënë të hollat te shtëpia e B.S, të cilin njëherit e ka djalë të hallës, ku me të njëjtin kanë hyrë brenda në shtëpi, ndërsa A. i ka pritur jashtë në oborr dhe më pas janë nisur me qëllim për të shkuar për të luajtur Sonny, ku prapë e kanë takuar E.B dhe i ka pyetur se ku po shkoni dhe të njëjtit i kanë thënë se po shkojmë të luajmë Sonny, dhe kur janë dal nga mëhalla, janë kthyer rrugës kah varrezat në rrugë ju ka dal një Golf 6, ngjyrë hiri, me rrotacion si të policisë, ku personat të cilët kanë qenë në atë automjet janë prezantuar si polic, të njëjtit i kanë pyetur se a je E.R dhe i kanë thënë eja me ne stacion policor, më pas duke menduar se janë polic, ka hipur në veturë dhe ka qenë edhe një person i tretë në veturë, gjoja se edhe ky ka qenë person që ka bërë ndonjë vepër penale, ku drejtuesi i automjetit dhe pasagjeri janë bërë kinse po e rrahin të njëjtin, ndërsa ndaj të dëmtuarit kanë filluar të përdorin dhunë, ku shoferi e ka goditur me dorë në fytyrë, duke i thënë se duhet t'ia jap paratë. Të njëjtit me veturë e kanë dërguar te shtëpia e hallës së tij dhe i kanë thënë të shkoj t'ia merr paratë ku pasagjeri e ka pritë jashtë veturës dhe i njëjti ka hyrë në shtëpi, i ka marr paratë dhe ua ka dorëzuar ku të njëjtit i kanë thënë se je i lirë dhe mos i trego askujt për këtë ngjarje. Më pas është nis për të dal nga lagja, ku e ka takuar motrën e A., E.B1 dhe i ka thënë a ma jap telefonin të bisedoj me A., dhe pastaj e ka takuar A, te kafe-çajtorja R..., dhe më pas i ka treguar se çka ka ndodhur.

I dëmtuari gjatë deklaratës së dhënë në polici i ka përshkuar personat të cilët e kanë detyruar t'ua jap paratë, duke theksuar se drejtuesi i automjetit ka pas flok të zeza të shkurta, njërin vetull të premë, pak më i shkurt me trup, i moshës rreth 22 vjeç, pasagjeri ka pasur të vendosur në kokë

kapele – kasketë të zezë, me trup i gjatë dhe i gjerë në krah, ka pasur të veshur jakne të zezë, i moshës mbi 35-36 vjeç, ndërsa personi i cili ka qenë ulur mbrapa me të ka pasur mustaqe të zeza, kapele të duksit të vendosur në kokë dhe trup mesatar. Nga ky procesverbal është vërtetuar se zyrtari policor i cili e ka intervistuar të dëmtuarin ia ka prezantuar 11 fotografi, duke e pyetur se a është ndonjëri nga këta persona prej atyre që të kanë marrë me veturë dhe i njëjti ka arritur të identifikoj personin në foton me numër 7, duke theksuar se i njëjti ka qenë i ulur në veturën Golf VI me të prapa, duke shtuar se të njëjtit i ka rënë telefoni në veturë prapa dhe ja ka parë foton e tij në telefon, duke shtuar se “telefoni është i njëjti me këtë që po e shoh në tavolinë” ndërsa që nga vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve të pandehurit B.Z i dt.27.12.2021, është vërtetuar se të pandehurit nga ana e policisë i është sekuestruar telefoni i markës Iphone VI ngjyre hiri, dhe përmes fotos i dëmtuari ka arritur të identifikoj këtë telefon, të cilin ia ka parë të pandehurit kur ka qenë duke qëndruar në veturën Golf VI, prapa me të, ndërsa që nga lista me fotografitë e 11 personave të dyshimë lidhur me këtë rast vërtetohet se i dëmtuari ka arritur të identifikoj personin me nr.7 si persona të dyshuar i cili ka qenë ulur mbrapa me të në veturë, e që ka rezultuar të jetë tani i pandehuri B.Z.

Nga deklarata e të dëmtuarit si dhe dëshmitarit A.B është vërtetuar se vëllai i këtij të fundit E.B ka qenë i njoftuar se i dëmtuari posedon një shumë të konsiderueshme të hollave pasi që me të kanë qëndruar edhe në kafenenë “M...”, dhe në prezencë të tij kanë diskutuar për paratë, ku pastaj i njëjti gjatë gjithë kohës e ka thirr në telefon vëllain e tij A. për ta pyetur se ku janë, e po ashtu gjatë rrugës për të shkuar te halla e të dëmtuarit me qëllim që t’i lënë paratë e kanë takuar dy herë, një herë duke shkuar dhe një herë duke dal në qytet, ku i njëjti i ka pyetur se ku po shkoni, e po ashtu gjatë kohës sa i dëmtuari dhe djali i hallës së tij kanë hyrë në shtëpi me qëllim që t’i lënë paratë, E.B e ka thirr vëllain e tij A. i cili ka qenë bashkë me këta të fundit, duke i kërkuar të takohen në fund të mëhallës i cili e ka pyetur se a i ke ti paratë dhe se kush i ka apo ku i keni lënë të njëjtat dhe ky i ka treguar se i kanë lënë në shtëpi te B.1.

Gjykata ka vlerësuar deklaratën e të dëmtuarit E.R, si dhe deklaratat e dëshmitarëve A.B, B.A dhe N.M, të cilat deklaratë ishte në tërësi në përputhje me njëra tjetrën, me deklaratat e tyre të dhëna pranë policisë si dhe me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e që këtyre deklaratave gjykata ua fali besimin, duke i gjetur si të vërteta, konsistente dhe në përputhje me shkresat tjera të lëndës.

Në Procesverbalin për intervistimin e te pandehurit B.Z në S.Policor ne Vushtrri i dt.27.12.2021, i njëjti ka deklaruar se më dt.25.12.2021 rreth orës 21:25 ka qenë duke shkuar në shtëpi ose brenda në shtëpi, ndërsa që para se të shkoj në shtëpi ka qenë në kafenenë “M...” bashkë me shokun e tij E.Z, ndërsa ka theksuar se E.B e ka përshëndet në ditën kritike ku ai ishte duke dal jashtë lokalit dhe ky ishte duke hyrë ndërsa që nuk ka biseduar me të. Ndërsa në Procesverbalin për intervistimin e te pandehurit B.Z në DRP-Mitrovice Jug i dt.21.02.2022, më dt.25.12.2021 rreth orës 21:25 ka deklaruar se ka qenë në kafenenë “M...” së bashku me shokun e tij E.Z duke shtuar se beson se aty ka qëndruar deri në ora 21:35min. Ka theksuar se ditën kritike nuk është takuar me E.B pasi që tërë ditën ka qenë në punë. Ndërsa që në mbrojtjen e paraqitur pranë kësaj gjykate i njëjti ka deklaruar se ditën kritike ka qenë në punë paradite, në firmën “ AB...”, ne ora 16:00 e ka përfunduar punën dhe ka shkuar ne shtëpi, me pas ka dal ne qytet ne ora 18:00 dhe është takuar me shokun e tij E.Z, me pas kanë shkuar ne kafiterinë “M...” ku kanë qëndruar rreth

30 minuta, dhe me pas ka shkuar ne shtëpi rreth orës 20:10 minuta, me taxi dhe me pas nuk ka dal nga shtëpia. Tutje ka deklaruar se personin me emrin E.B e ka takuar ditën kritike në kafenenë e lartcekur dhe e ka përshëndetur nga distanca, i njëjti ka qenë kontradiktor me vetveten edhe lidhur me faktin nëse e njeh personin me emrin E.B, ku në polici ka deklaruar se të njëjtin e njeh ndërsa që në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk e njeh të njëjtin. Tutje ka shtuar se ditën kritike është kthyer në shtëpi me taxi, ndërsa shokun e tij e ka lënë në qytet, ndërsa që më pas ka deklaruar se në taxi kanë qenë 3 persona, duke theksuar se nuk i mban mend të njëjtit. Gjatë gjithë kohën e ka mohuar të ketë kryer veprën penale ose të ketë njohur të dëmtuarin E.R.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të pandehurit të paraqitur në seancën e shqyrtimit gjyqësor, por që deklarimeve të tij nuk ia ka falur besimin, pasi që të njëjtit i ka gjetur si të pavërteta e me qëllim që ti shmanget përgjegjësisë penale, ndërsa edhe pse kishte mundësi që të ofronte prova që do të vërtetonin pafajësinë e pretenduar të tij, përveç që ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë, nuk ka ofruar asnjë provë dhe nuk ka bërë asnjë propozim që do ti kontribuonte këtij qëllimi, ose më saktë në asnjë formë nuk ka arritur ta provoj se nuk ka kryer veprën penale, e po ashtu deklarimet e tij se lidhur me kohën kur i njëjti ka shkuar në shtëpi pasi që ka qenë në kafenenë “M...”, deklarimet e tij lidhur me atë se ditën kritike a e ka takuar E.B dhe se a e njeh të njëjtin janë në kundërtënie me njëra tjetrën, e krejt kjo me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Neni 328 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton formën themelore të veprës penale *Detyrimi*, ashtu që theksohet se: *“Kushdo që me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, përdor forcën apo kanosjen serioze për të detyruar personin tjetër të kryej apo të mos kryejë ndonjë veprim në dëm të pasurisë së tij apo të personit tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

Nga provat në shkresat e lëndës dhe provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, u vërtetua mjaftueshëm se i pandehuri ka ndërmarr veprimet ashtu siç përshkruhet në dispozitivin e aktakuzës, ku me kanosje serioze e ka detyruar të pandehurin që t’ua jap shumën prej 3,808 euro, ashtu siç përcaktohet edhe në përkufizimin e dhënë nga neni 328 par.1 të KPRK-së, ashtu që vepra penale e detyrimit qëndron në detyrimin e tjetrit me forcë apo me kanosje serioze që të veprojë apo të mos veprojë në dëm të pasurisë së tij apo të personit tjetër, elemente këto që paraqesin figurën e veprës penale nga neni 328 par.1 të KPRK-së. E po ashtu qëllimi i cili ka qenë përfitimi material në mënyrë të kundërligjshme për vete ose për personin tjetër.

#### *Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat, por pa u kufizuar si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti faktin se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë madhor i ri, përkatësisht 20 vjeçar, ndërsa rrethana të tjera lehtësuese nuk gjeti, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjeti shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, në rastin konkret dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar, faktin se i pandehuri është recidivist i shumëfishtë në kryerjen e veprave penale me aktgjykim të formës së prerë P.nr. 1209/2019, si dhe aktgjykimin P.nr. 93/2021, i njëjti gjendet

në vuajtje të dënimit për kryerjen e veprave tjera penale, moshën e re të të dëmtuarit, përdorimin e situatës ku i pandehuri ka kërkuar nga personi tjetër në vazhdimësi të siguroj informata lidhur me vendndodhjen e të dëmtuarit, si dhe vendndodhjen e parave, shumën e konsiderueshme të parave të cilat kanë qenë në vlerë prej 3,808 euro, mënyrën e kryerjes së veprës penale, ku personat të cilët e kanë ndalur të dëmtuarin janë paraqitur si zyrtar policor, ndërsa që i pandehuri është paraqitur si i arrestuar nga ana e policisë.

Ashtu që, sipas bindjes së gjykatës, dënimi unik me burgim në kohëzgjatje prej në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe dënim me gjobë në shumën prej tre mijë (3000) euro, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale tjetër në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak nga dt.26.12.2021 deri më dt.25.05.2022 të pandehurit do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar konform nenit 79, par.1 të KPRK-së.

Duke vlerësuar të gjitha rrethanat e përshkruara më sipër gjykata të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke gjetur se ky dënim me burgim është dënim adekuat me shkallen e rrezikshmërisë se veprës penale, shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe pasojave të shkaktuara si dhe se me këtë dënim ndaj tij do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së. Duke i pasur parasysh të gjitha këto nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohet dënim me i butë ose me i rëndë.

*Arsyet lidhur me vendimin për shpenzimet e procedurës dhe kërkesën pasurore juridike.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e morri në bazë të nenit 449 par.2 nën par.2.6 dhe nenit 452 par.1 të KPPRK-së,

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e morri në bazë të nenit 36 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 par.2 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.”*

Nga çka u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË-DEGA VUSHTRRI**

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal,

P.nr.59/2023 e dt.26.03.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues

Agron Maxhuni

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga momenti i marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët.